



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2775 Prot.

Vlorë, më 31/08/2022



Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit

- Sektorit të Monitorimit të Borxhit Doganor

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të aktit administrativ – Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.142, me Nr.983/1 Prot., datë 04/08/2022 (bashkëngjitur), i materializuar për subjektin “**InMec**” sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë (Fshati Mifol, Zona Kadastrale 2689, nr pasurie 135/13-T, Rruga nacionale Vlorë-Fier Km 15), me përfaqësues ligjor z. Giuseppe Colucci,

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes së aktit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 983/1 Prot.

Vlorë, më 04/08/2022

V E N D I M N r. 1 4 2

Sot, më datë 04/08/2022, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Pas Zhdoganimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit Nr.1, date 01.03.2022, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit në ngarkim të subjektit “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë (Fshati Mifol, Zona Kadastrale 2689, nr pasurie 135/13-T, Rruga nacionale Vlorë-Fier Km 15), me përfaqësues ligjor z. Giuseppe Colucci,

K O N S T A T O V A S E :

Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Pas Zhdoganimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, bazuar në Program Kontrollin nr.18777 prot., datë 21/10/2021 dhe shtesë “Program kontrolli nr.18772/2 datë 18.11.2021”, ka ushtruar kontroll në Degën e Doganës Vlorë në lidhje me autorizimet për regjimin e përpunimit aktiv, sipas Udhëzimit nr.4 (nr.788 prot.) date 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv.

Pas kontrollit të ushtruar, grupi i kontrollit ka konstatuar disa mangësi dhe shkelje për të cilat paraprakisht është përpiluar shkresa Nr.18777/3 Prot., datë 05/01/2022 me lëndë “Njoftim Raporti Paraprak Kontrolli dhe procesverbalet e verifikimit të shkeljeve”, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr.83, datë 11/01/2022. Bashkëngjitur këtij materiali ndodheshin edhe Proces – Verbalet përkatës të kontrollit aposterior. Më tej, në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë është administruar shkresa Nr.18777/6 Prot., datë 04/03/2022, me lëndë “Raport Përfundimtar mbi Programin e Kontrollit nr.18777 Prot, datë 21.10.2021”, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr.83/2, datë 07/03/2022, bashkëngjitur të cilit ndodhet Proces Verbal Përfundimtar Nr.2, i mbajtur më datë 01.03.2022.

Bazuar në këtë Raport Përfundimtar, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, u hartua “Plani i Punës” me nr.1185 Prot., datë 13/04/2022, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga kontrolli dokumentar i ushtruar, rezulton se subjekti “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, me seli në Vlorë, për produktin përfundimtar të eksportuar me gjashtë deklarata eksporti, ka përdorur mallra të cilat nuk janë origjinuese, pasi janë importuar pa certificate origjine. Konkludojmë se për prodhimin

“konstruksione metalike për struktura në pjesë dhe aksesore”, nuk plotësohen kushtet, që kërkohet t'i nënshtrihen mallrat jo-origjinuese. Nga ana e Degës së Doganës Vlorë, është proceduar me shkresën Nr.983 Prot., datë 28.03.2022, me lëndë “Njoftim mbi të drejtën Tuaj për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar”. Si rrjedhim, nga ana e subjektit, është kryer kundërvajtje administrative në fushën doganore, pasi subjekti ka ndryshuar origjinën e produktit të eksportuar nga origjinë italiane (joorigjinuese) në preferenciale. Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkëlja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligji Nr.1/2012 “Për ratifikimin e konventës rajonale për rregullat preferenciale pan-euro-mediterrane të origjinës”, V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R të penalizohet në shumën **300.000** (Treqindmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore në përputhje me rezultatet e verifikimit doganor, të kryejë procedurat doganore për anulimin e certifikatave të qarkullimit EUR.1.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “InMec” sh.p.k, me NIPT L77308202R, i lejohe të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj

